



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 11/11/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 09/11/2020 të parashtruar nga i Grupi i operatorëve ekonomik **Iris Pharma SHPK; Ardi Sh.p.k** me përfaqësues Fatos Isenaj lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore.** me nr te prokurimit 613-20-5228-121 nxjerr këtë ;

VENDIM

Refuzohet si e pa e bazuar kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik **Iris Pharma SHPK; Ardi Sh.p.k** me përfaqësues Fatos Isenaj për aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore.** me nr te prokurimit 613-20-5228-121 ,

Vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 06/11/2020 mbetet në fuqi dhe vazhdon me procedura të mëtutjeshme.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve ekonomik **Iris Pharma SHPK; Ardi Sh.p.k** me përfaqësues Fatos Isenaj për aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore.** me nr te prokurimit 613-20-5228-121, me datë 09/11/2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e lartëpërmendur. Autoriteti Kontraktues, me datë 10/11/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Oferta juaj është refuzuar sepse me datë 30 tetor 2020 ju kemi dërguar letren për sqarim për çmimet që keni ofertuar që kanë qenë tepërt të ulta për artikujt që i kemi kërkuar dhe ju nuk jeni përgjigjur fare .


Në bazë të Rregullores për tenderët jo normalisht të ulët neni 4 pika 4.3 thotë: **“Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.”** .

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.**

Adem Duriqi



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit